



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 15 Shkurt 2022

Nr: 08

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 03, TË PARAQITUR NË KQZ NË  
DATËN 12.02.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.02.2022, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI - Relator  
Elvin LAKO - Anëtar  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” (LRE)

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 03, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, ‘Për shqyrtimin e kërkesë së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.



Data: 15 Shkurt 2022  
Nr. 08, Ora 12:00

“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, paraqitur në KQZ në datën 12.02.2022”

**BAZË LIGJORE:** Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Partia Lëvizja e Re (LRE) është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022 me vendimin nr.35, datë 02.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë “Lëvizja e Re”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.
2. Në datën 08.02.2022, LRE ka paraqitur në KQZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit të saj për kryetar bashkie në zgjedhjet e pjesshme për bashkinë Durrës, shoqëruar me dokumentacionin e kandidimit për z. Jonid Nano.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë dhe me vendimin nr. 72, datë 12.02.2022 ka vendosur mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, për shkakun se, dokumentacioni i depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se, subjekti zgjedhor nuk disponon mandat në këshillin bashkiak, Durrës. Vetëdeklarimi i zj. Alneida Nexhmi Rroshi, anëtare e këshillit bashkiak Durrës, se mbështet kandidatin e subjektit “Lëvizja e Re”, nuk përmbush kushtin ligjor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.
4. Subjekti zgjedhor LRE ka paraqitur kundër këtij vendimi ankim në KAS brenda afatit ligjor. KAS-i caktoi me short relatorin Ilirjan Rusmali dhe në seancën e datës 14.02.2022 vendosi



kalimin për shqyrtim të ankimit. Seanca e shqyrtimit u zhvillua në datën 15.02.2022 me pjesëmarrjen e ankuesit të përfaqësuar nga z. Arjan Galdini, zj.Evisa Nano dhe z.Jonid Nano, si dhe të administratës së KQZ-së të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit. Në seancë nuk u paraqitën kërkesa nga palë të interesuara.

5. Subjekti zgjedhor LRE e konsideron vendimin nr. 72, datë 12.02.2022, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 68 të Kodit Zgjedhor, si dhe afatet e përcaktuara nga vendimi i Komisionit Rregullator nr.2, datë 22.01.2022. Subjekti LRE arsyeton se, Kodi Zgjedhor nuk kërkon që për regjistrimin e kandidatit në zgjedhje *“zotëruesi i mandatit të këshillit bashkiak t'i përkasë subjektit zgjedhor të cilin ai mbështet, por (kërkon) që zotëruesi i mandatit bashkiak të ketë të paktën 6 muaj që e zotëron këtë mandat”*.
6. Subjekti zgjedhor LRE pretendon se KQZ-ja vepron me standart të dyfishtë, sepse me të njëjtin lloj dokumentacioni ka regjistruar kandidatin e saj për kryetar në bashkinë Dibër, ndërkohë që ka refuzuar kandidatin për kryetar në bashkinë Durrës.
7. Subjekti zgjedhor LRE pretendon se KQZ-ja ka bërë zbatim të gabuar të ligjit procedural, kur nuk i ka dhënë subjektit mundësinë për korrigjimin e parregullsive në dokumentacion, sikurse parashikon pika 10 e vendimit nr.2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullatorit.
8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - dosjen e kërkesës për regjistrim të paraqitur nga subjekti LRE;
  - shkresën nr.788 prot., datë 11.02.2022 të Komisionerit drejtuar këshillit bashkiak Durrës;
  - shkresën nr.1372/1, datë 11.02.2022 të Kryetarit të këshillit bashkiak Durrës drejtuar KQZ-së;
  - vendimin e KZAZ nr.19 Qarku Dibër me nr. 06, datë 11.02.2022 për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie;
  - vendimin e Komisionerit nr. 50, datë 10.02.2022;
  - Vendimin e Komisionerit nr.72, datë 12.02.2022.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,



## KAS-i konstatoi:

1. Vërtetimi për zotërimin e mandatit përfaqësues, sipas pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor bën pjesë në listën e dokumentave të nevojshëm për kandidim, në zëvendësim të listës mbështetëse prej jo më pak se 1 për qind e numrit të zgjedhësve, e cila kërkohet për regjistrimin e kandidatëve për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore (pika 2 e nenit 68 të Kodit Zgjedhor).
2. Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim trajtohet nga Kodi Zgjedhor si *conditio sine qua non* për regjistrimin e kandidatëve. Mangësitë ose parregullsitë në dokumentacionin e kandidimit passjellin refuzimin e regjistrimit nga ana e KQZ/KZAZ, në rast se ato nuk korrigjohen brenda afatit të përcaktuar për korrigjim. Në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, ky afat është 24 orë nga kthimi për plotësim (pika 10 e vendimit nr.2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”).
3. Pika 3, e nenit 68, të Kodit Zgjedhor vendos kushte forme dhe përmbajtjeje, me qëllim që vërtetimi për zotërimin e mandatit të jetë i vlefshëm dhe i pranueshëm. Vërtetimi duhet të lëshohet nga institucioni i Kuvendit ose nga organi i qeverisjes vendore dhe duhet të konfirmojë faktin se, mbështetur në vetëdeklarimin pranë institucionit nga ana e mbajtësit të mandatit, subjekti zgjedhor kërkues zotëron një mandat përfaqësues me vlefshmëri jo më të vogël se 6 muaj deri në përfundim të mandatit të organit përkatës. Vetëdeklarimi i përmendur në këtë pikë është një deklaratë përkatësie politike, e cila nënkupton një marrëdhënie zyrtare, publike dhe të qendrueshme midis mandatmbajtësit dhe subjektit politik, të cilit i përket ai. Kjo marrëdhënie përkatësie nuk vendoset me qëllimin për të shmangur kushtin e nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve në momentin e regjistrimit të kandidatëve. Ajo është marrëdhënie përkatësie që ekziston përtej dhe pavarësisht procesit zgjedhor. Për këtë arsye, ajo ka forcën që të zëvendësojë listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve si kusht për regjistrimin e kandidatëve.
4. Deklarimi i përkatësisë nga ana e mandatmbajtësit bëhet përpara institucionit dhe jo përpara administratës zgjedhore sepse marrëdhënia e tij e përkatësisë vlen jo vetëm për zgjedhjet, por vlen për çdo marrëdhënie juridike që bazohen në kriterin/kushtin e përkatësisë. Deklarimi i

përkatësisë është akt që lidh mandatbajtësin me subjektin politik dhe jo akt që lidh mandatbajtësin me kandidatin. Kodi Zgjedhor kërkon me pikën 3, të nenit 68 shpalljen e përkatësisë ndaj subjektit dhe jo, sikurse pretendon ankuesi, shpalljen e mbështetjes për kandidatin.

5. Ankuesi ka siguruar për kandidatin e tij për bashkinë Durrës mbështetjen e anëtares së këshillit bashkiak Durrës, zj. Alneida Rroshi, e cila ka nënshkruar një deklaratë mbështetëse dhe ka bashkëlidhur një vërtetim (shkresa nr.1043 prot., datë 02.02.2022) të lëshuar nga Kryetari i këshillit bashkiak Durrës, me të cilin konfirmohet se zj. Alneida Rroshi është anëtare e këshillit bashkiak. Si deklarata, ashtu dhe vërtetimi nuk përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor dhe janë diskualifikuar me të drejtë nga ana e Komisionerit, pas kryerjes së hetimit administrativ të rastit. Komisioneri ka kërkuar dhe ka marrë nga këshilli bashkiak Durrës vërtetimin (shkresa nr.1372/1 prot., datë 11.02.2022) se zj. Alneida Rroshi është anëtare e Këshillit Bashkiak Durrës, nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Pavarësisht se deklaroi mbështetjen për kandidatin e LRE, anëtarja e Këshillit Bashkiak Durrës nuk është vetë në marrëdhënie përkatësie me LRE. Mandati i saj përfaqësues nuk i përket LRE, por i përket PSSH, për pasojë ai nuk mund të zëvendësojë ligjërisht nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve për llogari të LRE, por vetëm për llogari të PSSH.
6. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë, KAS-i u ndal edhe në pretendimin për “standard të dyfishtë” lidhur me rastin LRE-Dibër. Hetimi administrativ provoi se regjistrimi i kandidatit të LRE për bashkinë Dibër është bërë nga KZAZ-ja nr.19. Kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim. Vendimarrja e KZAZ nr.19 është brenda kompetencës së saj, sikurse vendimarrja e Komisionerit është brenda kompetencës së tij. Dy vendime të ndryshme për kazuse të ngjashme nuk krijojnë standart të dyfishtë, kur merren nga dy organe të ndryshme kompetente, sa kohë që nuk i nënshtrohen që të dy rrugës ligjore të ankimit. Rruga ligjore e ankimit çon tek standarti uniform ose i dyfishtë, në varësi nga vendimarrja e organit kompetent për shqyrtimin e ankimeve.
7. KAS-i konstaton se, kthimi i dokumentacionit për plotësim përfshin edhe rastin kur vërtetimi për zotërimin e mandatit nuk plotëson kërkesat e pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor. Në raste si ky, subjekteve zgjedhore duhet t’u njihet e drejta për të risjellë vërtetimin sipas formatit të kërkuar nga ligji, ose për të sjellë listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve. Kthimi për plotësim është mjet ligjor në ndihmë dhe dobi të subjekteve zgjedhore. Mohimi i tij përbën



cënim të standartit zgjedhor dhe, varësisht nga rrethanat, mund të shënojë diskriminim të qëllimshëm për subjektet zgjedhore, të cilëve u mohohet kjo e drejtë.

8. Ankuesi ka pasur mundësinë që të bënte plotësimin dhe të sillte vërtetimin e saktë ose listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve dhe t'i depozitonte ato në KAS. Por KAS-i nuk është kompetent për shqyrtimin e tyre dhe nuk mund të administrojë këtë dokumentacion. Kompetenca është e Komisionerit, sikurse vendimmarrja lidhur me regjistrimin është e tij. Kështu që, vendimmarrja korrekte e KAS-it do ishte kthimi i çështjes për kompetencë tek Komisioneri. Ankuesi nuk ka depozituar dokumentacionin e korigjuar, por ka preferuar të kërkojë që KAS-i të njohë dhe respektojë të drejtën e tij për plotësim dokumentacioni brenda afatit të përcaktuar nga vendimi nr.2, datë 22.01.2022, i Komisionit Rregullator. KAS-i e konsideron këtë kërkim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Për këtë arsye, KAS-i çmon se kjo mundësi i duhet dhënë ankuesit për një afat të ri 24 orë nga shpallja e këtij vendimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 30, pika 1, shkronja “c”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim.
3. Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti “Lëvizja e Re” të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit



Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhëve, sipas pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

